



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E  
SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE  
MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***28 - 30 Nëntor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



# Lajm

MAQEDONI

## Maqedonia në prag të fillimit të një sezoni të vërtetë të gripit



Gjatë javës së 47-të të vitit 2015 (16.11 – 22.11.2015), në Republikën e Maqedonisë prej dhjetë njëjësive raportuese janë raportuar 100 raste të gripit me incidencë prej 4.8 në 100.000 banorë, që është një rënie prej 24,2 për qind krahasuar me javën e kaluar (132).

Siç njofton Sektori për kontroll dhe parandalim të sëmundjeve infektive pranë Institutit të shëndetit publik, numri i personave të raportuar gjatë kësaj jave është për 36,7 për qind më i vogël me atë në javën e 47 të sezonit të kaluar kur janë regjistruar 158 raste.

Gjatë kësaj jave numri i rasteve edhe pse i përafërt, sërish është nën numrin 120 që shënon kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit, që u tejkalua gjatë javës së kaluar. Kjo do të thotë se aktiviteti i virusit është në kufi dhe lëviz në nivelet e zakonshme sezonal, që do të thotë se ndodhemi në pragun e fillimit të një sezoni të vërtetë të gripit.

Si edhe gjatë javës së kaluar, në javën e 47 numri më i madh i të sëmurëve (79) janë raportuar në grupmoshën që përfshin pjesën më të madhe të popullatës nga 15-64 vjet, ndërsa morbiditetet më të lartë Mb (9.9/100.000) është regjistruar tek më të rinjtë – fëmijët në moshën 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave pranë Institutit të shëndetit publik kanë arrirë 3 materiale biologjike për analizë laboratorike. Gjatë sezonit 2015/16 nga 15 mostrat e arrira deri tani, asnjë nuk ka rezultuar pozitiv për prani të gripit.

Numri i përgjithshëm i rasteve të raportuara këtë sezon është 556, ndërsa incidenca kumulative është – 26.9/100.000 banorë. Në këtë sezon persona të sëmurë janë raportuar nga 15 njësi raportuese. Numri më i



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



madh i tyre janë regjistruar në QSHP Tetovë (211), QSHP Kumanovë (115) dhe QSHP Prilep (88), ndërsa në njësitë e tjera raportuese janë regjistruar raste sporadike.

Sa i përket shpërndarjes sipas grupmoshave, numër më të madh të të sëmurëve ka në grupmoshën 15-64 vjet – 379 (68,2 për qind), ndërsa incidencë kumulative më të madhe prej 40.6/100.000 banorë është regjistruar tek fëmijët e moshave shkollore nga 5-14 vjet.



## Dita e drurit nuk anulon kontrollimet dhe operacionet

**Shkup, 30 nentor** - Minsitria e Shëndetësisë (MSH) informon opinionin se të mërkurën (2 dhjetor) të gjitha shtëpitë shëndetësore do të punojnë në mënyrë të rregullt në shtet dhe se do ti realizojnë të gjitha intervenimet dhe kontrollimet e caktuara.

MSH deri tek të gjitha shtëpitë publike shëndetësore ka dërguar njoftim se në "Ditën e drurit", të mërkurën të gjithë do të punojnë.

Sipas të dhënave të sistemit nacional elektronik të evidencave në shëndetësi 'Termini im', vërtetohet se për atë ditë më shumë se 8000 pacientë kanë caktuar termin të rregullt ndërsa mbi 500 intervenime kirurgjike.



## Gripi sezonal fillon të përhapet, më shumë të sëmurë regjistrohen në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep



Javën që lamë pas, në vend janë regjistruar njëqind raste të reja të gripit, tregojnë të dhënat nga Instituti i shëndetit publik. Analizat e epidemiologëve thonë se aktiviteti i virusit ndryshon nga niveli sezonal, që do të thotë se jemi në prag të hyrjes të sezonit të vërtetë të gripit. Më shumë



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



të sëmurë ka në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep. Në Shkup mjekët amë thonë se akoma nuk kanë shumë pacientë me grip. Ordinancat kryesisht i mbushin njerëz me sëmundje kronike.

“Të sëmurët kronik zakonisht vijnë me kollitje dhe u zihet fryma, që ndoshta është rezultat i motit të ndryshueshëm dhe ndoshta të ndotjes së ajrit në Shkup. Të shmangen tubimet e shpeshta, sepse këtu ndodh bartja e sëmundjes nga një person në tjetrin, zakonisht të mbajnë llogari rreth të ushqyerit dhe të marrin më shumë lëngje dhe vitamina në dimër”, tha Jovana Kostovska- mjek amë në Poliklinikën e Bit pazarit.

Mjekët rekomandojnë për vëmendje të veçantë dhe mbrojtjen e grupeve të rrezikuara, tek të cilët mund të zhvillohen komplikime nga gripin, si të sëmurit me sëmundje kronike, fëmijët dhe të moshuarit. Për këta persona rekomandohet vaksinimi.



## Një delegacion qeveritar për vizitë në Ministrinë e Shëndetësisë



**Një delegacion qeveritar, i udhëhequr nga ministri i Ekonomisë Bekim Neziri, zëvendës-kryeministri Fatmir Besimi dhe deputetja Vjollca M. Nuredini do të zhvillojnë vizitë pune në Ministrinë e Shëndetësisë, ku do të takohen me sekretarin shtetëror, Nasuf Ipçe...**

Në takim, i cili do të mbahet në ora 12:30, delegacioni do të njoftohet nga sekretari shtetëror Ipçe, me projektet që janë realizuar nga ky dikaster gjatë viteve 2014 dhe 2015 si dhe projektet që janë në vijim e sipër.

Në takim do të jenë të pranishëm edhe 24 drejtorët shqiptarë të klinikave të Shkupit, ndërsa pas takimit do të ketë deklarata për media.

Në orën 13:30 minuta delegacioni qeveritar do të viziton Klinikën e syve, me ç'rast do të njoftohet me metodat e reja të intervenimeve që kjo klinikë zbaton. (mia.mk)

MAQEDONI

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Familja Duraku nga Tetova vuan për kafshatën e gojës - 071/681-440



**Pamjet e filmuara tregojnë qartë për varfërin e thelle në familjen 6 antarëshe Duraku nga Tetova...**

Nëna Fikrie me lot në sy tregon për hallet e shumta që i mban mbi supë, po të mos kishin qenë fqinjët nuk di se si do ti ushqeja 4 fëmijët.

8 mij denartë që I mar nga fëmiju I tretë më shkojnë te rryma, prej në kohën e luftës I paguaj borxhet jam sprovuar dhe kam ndenjur gjashtë muaj pa rrymë dhe e kam patjetër ti paguaj thotë.

**"Parat që do të më vinë për vajzën duhet të paguaj rrymën që mos të ma ndalin, 6 muaj kam ndenjur pa rrymë, dhe tash e kam patjetër ta paguaj, fëmijët kanë pasur ftohet, rinin të mbuluar me qebe dhe jorganë, te kojshikja i kam mbajtur më shumë pasi ajo kishte dru, i veshja trashë, as makinë për të larë tesha nuk kam, cdo gjë laj në dorë, mezi kam bërë idare, kojshikat më kanë ndihmuar, ato mi kanë mbajt fëmijët me haje me pije, me veshje",** shprehet Fikrie Duraku.

Me lotët rrëke dhe duke ofkëlluar tregon se gati katër ditë vajzën e dytë e ka në spital në Shkup, nuk kam para për të paguar shpenzimet e vajzës e jo më të paguaj shpenzime shtesë, zëmra më digjet për të vijon duke mos e ndarë nga dora fotografën e saj.

**"Unë nuk kam mundësi të ri atje, 2000 denar nata është, 3 netë 100 euro duhet, e lash vajzën vetëm që ta shikojnë cfarë ka cfarë jo, të shikojmë doktori cka do të na thotë, merzin e mbaj në vete, nuk e nxjerr, shumë mërzitem për vajzën, me cfarë të shkoj, në spital më thonë medoemos",** shprehet Fikrie Duraku.

Gjendjen e rrëndë në familje e përjeton më thellë vajza më e madhe Sara, 11 vjece, e cila është victim e varfërisë. Prindërit dhe të afërmit thone se ajo nuk ka asnjë problem shëndetësor ndërsa është e regjistruar në shkollën "Liria", në paralelen speciale.

## Kryqi i kuq i Maqedonisë, 20 vjet nga pranimi në organizatën ndërkombëtare

Kryqi i Kuq i Maqedonisë shënoi 20 vjetorin e pranimit në organizatën ndërkombëtare të kryqit të kuq...





FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



Црвен крст на Република Македонија

Kjo organizatë sfidave të shumta humanitar përfshi edhe numrin e madh të refugjatëve nga zonat e luftës të cilët tranzitojnë nëpër Maqedoni drejt vendeve të BE-së.

**“Përveç sfidave tradicionale, që deri tash e kemi punuar, themi se ne si organizatë përgaditemi për sfidën kryesore e cila 2014 dhe 2015, është impunuar, ajo është sfida të cilat meren me ndihmat e refugjatëve, të cilët tranzitojnë nëpër Maqedoni”** – tha sekretari i Kryqit të Kuq të Maqedonisë, Sait Saiti.

Kontributin e kryqit të Kuq për refugjatët e theksoi edhe kryeparlamentari Trajko Veljanovski.

**“Kryqi i kuq kontribonë me tërë kapacitetin e vet për përkrahjen e migrantëve në të dy pikat kufitare, Tabanovc dhe gjevgjeli. Gjithashtu kryqi i kuq si bazë kryesore të aktiviteteve ka edhe dhurimin e gjakut, një ndër ndihmat e para me shkallë më të lartë”** – deklaroi kryetari i Kuvendit, Trajko Veljanovski.

Me 27 nëntor të vitit 1995 në Gjenev, kryqi i kuq i Maqedonisë është pranuar si anëtare fuqiplotë dhe e 169 në në lëvizjen ndërkombëtare të Kryqit të Kuq. (Rejhane Bushi – Metaj, TVM2)

**PORTALB**  
dritare realiteti

## Gripi sezonal fillon të përhapet



Javën që lamë pas, në vend janë regjistruar njëqind raste të reja të gripit, tregojnë të dhënat nga Instituti i shëndetit publik. Analizat e epidemiologëve thonë se aktiviteti i virusit ndryshon nga niveli sezonal, që do të thotë se jemi në prag të hyrjes të sezonit të vërtetë të gripit.

Më shumë të sëmurë ka në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep. Në Shkup mjekët amë thonë se akoma nuk kanë shumë pacientë me grip. Ordinancat kryesisht i mbushin njerëz me sëmundje kronike.

“Të sëmurët kronik zakonisht vijnë me kollitje dhe u zihet fryma, që ndoshta është rezultat i motit të ndryshueshëm dhe ndoshta të ndotjes së ajrit në Shkup. Të shmangen tubimet e shpeshta, sepse këtu ndodh bartja e sëmundjes nga një person në tjetrin, zakonisht të mbajnë llogari rreth të ushqyerit dhe të marrin më shumë lëngje dhe vitamina në dimër”, tha Jovana Kostovska- mjek amë në Poliklinikën e Bit pazarit.

Mjekët rekomandojnë për vëmendje të veçantë dhe mbrojtjen e grupeve të rrezikuara, tek të cilët mund të



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: info@fzo.org.mk



zhvillohen komplikime nga gripi, si të sëmurit me sëmundje kronike, fëmijët dhe të moshuarit. Për këta persona rekomandohet vaksinimi.



## Dita e drurit nuk anulon kontrollimet dhe operacionet



Minsitria e Shëndetësisë (MSH) informon opinionin se të mërkurën (2 dhjetor) të gjitha shtëpitë shëndetësore do të punojnë në mënyrë të rregullt në shtet dhe se do ti realizojnë të gjitha intervenimet dhe kontrollimet e caktuara.

MSH deri tek të gjitha shtëpitë publike shëndetësore ka dërguar njoftim se në "Ditën e drurit", të mërkurën të gjithë do të punojnë.

Sipas të dhënave të sistemit nacional elektronik të evidencave në shëndetësi 'Termini im', vërtetohet se për atë ditë më shumë se 8000 pacientë kanë caktuar termin të rregullt ndërsa mbi 500 intervenime kirurgjike.

## Gripi sezonal fillon të përhapet



Javën që lamë pas, në vend janë regjistruar njëqind raste të reja të gripit, tregojnë të dhënat nga Instituti i shëndetit publik. Analizat e epidemiologëve thonë se aktiviteti i virusit ndryshon nga niveli sezonal, që do të thotë se jemi në prag të hyrjes të sezonit të vërtetë të gripit.

Më shumë të sëmurë ka në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep. Në Shkup mjekët amë thonë se akoma nuk kanë shumë pacientë me grip. Ordinancat kryesisht i mbushin njerëz me sëmundje kronike.

"Të sëmurët kronik zakonisht vijnë me kollitje dhe u zihet fryma, që ndoshta është rezultat i motit të ndryshueshëm dhe ndoshta të ndotjes së ajrit në Shkup. Të shmangen tubimet e shpeshta, sepse këtu ndodh bartja e

sëmundjes nga një person në tjetrin, zakonisht të mbajnë llogari rreth të ushqyerit dhe të marrin më shumë lëngje dhe vitamina në dimër", tha Jovana Kostovska- mjek amë në Poliklinikën e Bit pazarit. Mjekët rekomandojnë për vëmendje të veçantë dhe mbrojtjen e grupeve të rrezikuara, tek të cilët mund të zhvillohen komplikime nga gripi, si të sëmurit me sëmundje kronike, fëmijët dhe të moshuarit. Për këta persona rekomandohet vaksinimi.